



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KUVENDI KOMUNAL/ASSEMBLY OF MUNICIPALITY/SKUPŠTINA OPŠTINA
SKENDERAJ



Komuna Skenderaj
Opština Skenderaj
Municipality of Skenderaj

Nr. 09-052/01-0002574/25
Data: 16.09.2025

Drejtoria për Shërbime Publike
Direkcija za Javne Službe
Department for Public Services

DATE/A:	16.01.2025
PËR	Kryetarin e Komunës: z. Fadil Nura
PËRMES/PREKO/ THROUGH:	Arkivës
NGA/OD/FROM:	Drejtori -Drejtorisë se Shërbimeve Publike: Alban Shala
TEMA/SUBJEKAT/ SUBJECT:	Raporti i punës për vitin 2024

Duke u bazuar ne objektivat dhe aktivitete e Drejtorisë për Shërbime Publike për vitin 2024 kemi ngritje të nivelit të shërbimeve efikase dhe cilësore ndaj qytetareve si dhe përmirësimi i kushteve sociale për qytetare ne kuadër të sektorëve për shërbime publike dhe sektorit për emergjence ne Drejtorinë për Shërbimeve publike. Kjo drejtori ka si qëllimin arritjen e objektivave dhe planave sipas aktiviteteve të shërbimeve publike, në tërë territorin e Komunës se Skenderajt. DSHP-ja ka të ndara shërbimet në dy njësi (sektorë) themelore, ku secila ka detyrat dhe përgjegjësit e saj.

Drejtoria e Shërbime Publike ne baze të punës për vitin 2024 edhe përkundër sfidave ka arritur me sukses përfundimin dhe realizimin e projekteve sipas planifikimeve buxhetore dhe kryerjen e detyrave tjera të punës të paraparë në kuadër të drejtorisë.

Drejtoria ju është përgjigjur kërkesave të qytetarëve që kanë të bëjë problemet e ndryshme për realizimin e të drejtave dhe ankesave në afatin e paraparë procedurale që përcaktojnë ligjet, rregulloret dhe statuti i komunës.

Në vazhdim jane te raportuar nje mori aktivitetestesh dhe punë të kryera gjate vitit 2024.

- Mirëmbajtjen dhe pastrimin e hapësirave publike gjelbëruese, sheshit, rrugëve, trotuareve punët të cilat i ka kryer ndërmarrja komunale "NPL Eko Natyra .Sh.A" Skenderaj,
- Gjelbërimi i hapësirave publike mbjelljen e luleve sezonale në qytet,
- Kemi bashkëpunuar me kompaninë regjionale te ujësjellësit "KRUM" që ofron shërbime rreth furnizimit me ujë, ne sanime te defekteve ne rrjetin e ujit, dhe rrjetit të kanalizimit,
- Larjen e rrugëve te qytetit dhe sheshit Adem Jashari,
- Rehabilitimi dhe mirëmbajtja e rrjetit te kanaleve të ujërave të zeza dhe kanaleve te reshjeve atmosferike përmes kompanisë se kontraktuar.
- Mbikëqyrja e realizimit të shërbimeve që janë ofruar nga Bashkësia Islame në Skenderaj sipas memorandumit në mes Kryetarit të Komunës se Skenderajt.

- Mbikëqyrjen dhe kontrollin e shërbimeve të ofruara nga Kompania kontraktues për Sigurimi fizik të objekteve të komunës së Skenderaj,
- Mirëmbajtjen e rrjetit të ndriçimit publik duke intervenuar në sanimin e defekteve përmes kompanisë së kontraktuar nga Komuna e Skenderajt,
- Dhënia e vendimeve, pëlqimeve për shfrytëzimin e përkohshëm të hapësirave publike,
- Mirëmbajtja e drunjeve dekorative në qytet,
- Menaxhimi i mbeturinave në komunën e Skenderaj dhe eliminimin e deponive ilegale të mbeturinave, në bashkëpunim me Kompaninë Rajonale "Unitetit",
- Mirëmbajtja e rrugëve gjatë sezonit dimërorë, dhe largimin e shembjeve të dheut, përmes kompanisë kontraktuese,
- Menaxhimi i mbeturinave në komunën e Skenderaj, Hartimi i planeve dhe strategjive komunale për menaxhimin e mbeturinave;
- Monitorimi hapësirave publike për menaxhimin e mbeturinave,
- Planifikimi dhe trajtimi i mbeturinave, Organizimi dhe administrimi i mbeturinave
- Pjesëmarrja në procesin e hartimit të draft plani ndër komunal për menaxhimin e integruar të mbeturinave në bashkëpunim me komunat e regionit si me komunat Mitrovicës, Vushtrrisë dhe Skenderajt.
- Hartimi i raportit vjetor për menaxhimin e mbeturinave; Monitorimi i rregullores komunale për MM
- Planifikimin e hapësirave për vendosjen e kontejnerëve dhe përcaktimi i pikave statike për mbeturina dhe rregullimi i tyre
- Vendosjen e shenjave për kujdesin ndaj ambientit për mos hedhje të mbeturinave,
- Identifikimi i deponive ilegale në territorin e komunës së Skenderaj për vitin 2024,
- Është bërë largimi i deponive ilegale të mbeturinave në qytet dhe neper fshatrat e komunës së Skenderaj.

Marrëveshjet me NPL EKO Natyra:

Mirëmbajtjen dhe pastrimin e 8 hapësirave të gjelberta publike me 8966 ha.

Mirëmbajtjen e rrugëve dhe troturave në qytet dhe bashkësi lokale gjatë sezonit veror.

Mirëmbajtja e hapësirave publike dhe ndriçimit publik. Të gjitha hapësirat publike me ndriçim publik.

Në kuadër të aksionit për eliminimin e deponive ilegale në komunën e Skenderaj,

Përshkrimi	Sasia e deponive
Deponi të vogla	27
Deponi të mesme	46
Deponi të mëdha	44
Mako-deponi të mëdha e të përziera	17
Totali:	136 Deponi

Gjatë vitit DSHP-ja ka pasur një numër të lartë të lendeve të cilat janë shqyrtuar dhe proceduar në afatin ligjor:

5.	Ne proces	0	Lëndë
6.	Pezulluara	7	Lëndë
7.	Hedhura poshtë	2	Lëndë
8.	Anuluara	2	Lëndë

Te gjitha lendet janë trajtuar dhe proceduar sipas afateve ligjore , dhe pas shqyrtimit të lendeve janë dërguar ne arkivin e komunës se Skenderajt.

Ne kuadër të sektori për Mbrojtje dhe Shpëtim janë kryer një sere aktiviteteve dhe detyra të planifikuara dhe të pa planifikuara të rasteve emergjente të paraqitura gjatë vitit 2024.

-Është kryer Plani i Punës për vitin 2024.

-Janë dorëzuar ne Komisionin Qeveritarë ne AME ne Prishtinë të gjitha lendet e vlerësuara nga demet e shkaktuara nga ERA qe ka përfshirë komunën tonë me dt. 02.12.2023.

-E kemi përgatitur Planin e trajnimeve për vitin 2024 sipas kërkesës se AME-së dhe i kemi caktuar vijuesit nga SMSH dhe SHZSH qe do te marrin pjesë sipas periudhës kohore.

Spektori për Mbrojtje dhe Shpëtim si pjese e DSHP-se ka qene pjesëmarrëse e komisionit për vlerësimin e dëmeve nga F.N.F.T. ku janë shqyrtuar kërkesa te qytetarëve për demet ne bujqësi dhe për demet ne ekonomi familjare.

Po ashtu ky sektor përmes operatoreve kontraktues ka qene i angazhuar ne hapjen e lumenjve dhe e gypave atmosferike gjate rasteve emergjente të shkaktuara nga vërshimet.

Njësia Profesionale e Shërbimit të Zjarrfikësve – NJPSHZ, po ashtu ka qene angazhuar gjate viti 2024 ne intervenime te ndryshme emergjente, te raportuara nga organet e rendit dhe qytetaret për rastet e shkaktuar nga zjarri dhe fatkeqësitë natyrore era dhe reshjet atmosferike.

Ky raport përmbledhës thekson aktivitetet kryesore që kanë ndodhur gjatë periudhës vjetore 2024

Tabela 1.

Intervenimet 2024				
NR	Emrërimet	Spektori për Mbrojtje dhe Shpëtim - SMSH	Njesia Profesionale e Shërbimit të Zjarrfikësve - NJPSHZ	GJITHSEJ
1	Intervenimet në fatkeqësi natyrore	131		131
2	Vershimet,Era,Zjarre,Breshëri	0,18,26,77,		121
3	Shërbimet teknike	10		10
4	Shuarja e zjarreve		253	253
5	Intervenimet teknike		27	27
		TOTALI :		411

Tabela 2.

Vlerësimet e dëmeve nga Fatkeqsitë Natyrore dhe Fatkeqsitë Tjera-2024				
NR	Emrërimet	Nr. i rasteve	Shuma	GJITHSEJ
1	Demet në Bujqësi	116	386,197.70 €	386,197.70 €
2	Demet ne Ekonomi Familjare	9	81,197.70 €	81,197.70 €
3	Demet ne Biznese	0	0	0
4	Infrastruktura	0	0	0
5	Institucione tjera	0	0	0
		TOTALI :		467,960,19 €

Drejtori:

Alban Shala

